# MARCONOL IMPREGNANTE

MBROJTES KOLORANT PER DRU TE EKSPOZUAR

**seri 843**

## PËRSHKRIMI

MARCONOL IMPREGNANTE është produkt për mbushjen sipërfaqësore të drurit. Ka fuqi të lartë penetruese e nevojshme për mbrojtjen nga agjentët atmosferikë dhe ndotësit, edhe në ambiente me kushte të rënda/ekstreme, duke mbetur I paprekur/pacënuar edhe në variacionet strukturore natyrale të drurit.

MARCONOL IMPREGNANTE është I disponueshëm në ngjyra transparente që përftohen nëpërmjet pigmenteve mineralë të mikronizuar, që mbrojnë drurin nga rrezet U.V. dhe rikthen tonalitetet duke lënë të dukshme damarët orgjinale. Për të shtuar plotësinë dhe në rastet e ekspozimeve në kushte veçanërisht të rënda/ekstreme, është I këshillueshëm aplikimi I një mbishtrese MARCONOL CERATO s.863.

## UDHËZIME PËR PËRDORIMIN

I aplikueshëm në dru të ri ose të lyer, brenda dhe jashtë, papafingo, korniza dritaresh, ballkone, gardhe etj.

VEMENDJE në trajtimin e drurëve të pasur me taninë (psh gështenja) mund të shfaqin njolla të errëta.

## KARAKTERISTIKA TEKNIKE

-Natyra e lidhësit: rezinë alkidike, vaj lini krudo.
-Pigmentë: okside hekuri transparentë, rezistentë ndaj rrezeve U.V.
-Solventi: përzierja e hidrokarbuereve alifatikë
-Dendësia UNI EN ISO 2811-1: 0,84±0,03 kg/l (sipas pigmenteve/ngjyrave)
-Koha e efluzionit/daljes UNI EN ISO 2431: 30"-33" Kupa Iso n.3 a 25 °C
-Tharja (në 25 °C dhe 65% di U.R.): larg pluhurit (fuori polvere) për 2 orë, në prekje pas 8 orësh, shtresa tjetër pas 24 orësh.
RILYERJA:
Me MARCONOL CERATO s. 863, llak alkidik MARCONOL SUPERMARE s. 848, MARCONOL FLATTING 8460619 dhe me të gjithë smaltet alkidikë SAN MARCO.
Nuk këshillohet me llaqe nitro.

## PËRGATITJA E SIPËRFAQES

-Zmeriloni lehtësisht për të hequr/larguar fibrat e ngritura të drurit.
-Hiqni rezinën/llakun e pranishëm duke përdorur diluentin e përshtatshëm.
-Stukoni parregullsitë me stuko sintetike. Zmeriloni stukimet dhe eliminoni pluhurin.
-Kontrolloni që druri të mos jetë shumë I lagësht.
-Zmeriloni sipërfaqet dhe vazhdoni me aplikimin e MARCONOL IMPREGNANTE në ngjyrën e dëshiruar, duke zmeriluar kalimin nga njëra shtresë në tjetrën për të hequr fibrat e ngritura.

Sipërfaqe në dru të lyer:
-Zmeriloni për të hequr/larguar fibrat e ngritura të drurit.
-Eliminoni shtresat e bojës së vjetër të ciflosur dhe ashpërsoni/zmeriloni të gjithë sipërfaqen e lyer.
-Hiqni rezinën/llakun e pranishëm duke përdorur diluentin e përshtatshëm.
-Stukoni parregullsitë me stuko sintetike. Zmeriloni stukimet dhe eliminoni pluhurin.
-Zmeriloni sipërfaqet dhe vazhdoni me aplikimin e MARCONOL IMPREGNANTE.

## UDHËZIME PËR APLIKIM

-Kushtet e ambientit dhe të sipërfaqes
Temperatura e ambientit: Min. +8 °C / Max. +35 °C
Lagështira relative e ambientit: <75%
Temperatura e sipërfaqes: Min. +5 °C / Max. +35 °C
Lagështira e sipërfaqes: <10%
-Shmangni aplikimet në prani të sipërfaqeve me kondensim ose nën veprimin direkt të diellit.
-Mjetet: pinel, spruco
-Ripërzieni në mënyrën e duhur produktin para përdorimit.
-Produkti është gati për përdorim. Në momentin që sipërfaqa rezulton pak absorbuese holloni me Acquaragia 5200010 ose me Dil.Sintetico 5210011 për të favorizuar penetrimin (max 10%).
-Nr i shtresave: produkti aplikohet në 2 shtresa. Në kushte ambientale veçanërisht të rënda/ekstreme ose të sipërfaqeve shumë absorbuese është I këshillueshëm aplikimi I 3 shtresave.
-Për aplikimet në sipërfaqe të jashtme këshillohet përdorimi I MARCONOL IMPREGNANTE në ngjyrë, duke qenë se janë pigmentet (oksidi I hekurit) që kryejnë funksionin mbrojtës ndaj rrezeve UV.
-Pastrimi I mjeteve bëhet me Acquaragia 5200010 ose me Dil. Sintetico 5210011.
-Shkalla e mbulimit: 4-5 $m^2$/l në 2 shtresa në dru mesatarisht absorbues. Eshtë mirë që të

Eraldi shpk

përcaktohet rrezja efektive me një provë paraprake në sipërfaqe specifike.

## NGJYROSJA

Produkti është I disponueshëm në versionin pa ngjyrë dhe në ngjyrat e kartelës/katalogut.

## MAGAZINIMI

Temperatura maksimale e ruajtjes: +30 °C
Temperatura minimale e ruajtjes: +5 °C
Produkti preferohet të përdoret brenda 3 vitesh nga data e prodhimit, nëse është ruajtur në ambalazh origjinal të pahapur dhe në kushte në temperaturë të përshtatshme.

## UDHËZIME SIGURIMI

Vlera limite BE (Dir. 2004/42/EC)
Kat. A/f: impregnanti (mbushësa) jo filmogjen për dru (bazë solventi): 700 g/l (2010)
MARCONOL IMPREGNANTE Përmban max: 700 g/l VOC
I dëmshëm- I ndezshëm
Produkti duhet të transportohet, përdoret dhe ruhet sipas rregullave aktuale të shëndetit dhe sigurisë; pas përdorimit mos I hidhni mbetjet në ambient, I lini të thahen dhe I trajtoni ato si mbetje të veçanta.
Për më shumë informacion konsultohuni me skedën e sigurisë.

## SPECIFIKIMET

Impregnante (mbushës) transparent I ngjyrueshëm për dru.
Aplikimi, në sipërfaqe druri të predispozuara për impregnante (mbushës) transparent të ngjyrueshëm për brenda dhe jashtë MARCONOL IMPREGNANTE s. 843, me bazë rezinë alkidike, vaj lini krudo dhe oksid hekuri te mikronizuar, mbrojtës ndaj rrezeve ultravjollcë, në të paktën 2 shtresa në sasinë e caktuar nga absorbimi I sipërfaqes.
Furnizimi dhe instalimi i materialit € ................ për m².

*SAN MARCO GROUP garanton që informacionet e kësaj skede janë marrë nga eksperienca e saj dhe nga njohjet e saj teknike dhe shkencore; megjithatë nuk mund të mbajë asnjë përgjegjësi për rezultatet e arritura duke qenë se kushtet e aplikimit janë jashtë kontrollit të saj. Këshillohet të verifikohet gjithmonë efikasiteti I produktit. Skeda e paraqitur anullon dhe zëvendëson çdo skedë të mëparshme. Për informacione të mëtejshme teknike kontaktoni në nr.pa pagesë të Asistencës Teknike 800853048.*

Eraldi shpk